

LIGJ
Nr.8432, datë 14.12.1998

PËR AZILIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

1. Me këtë ligj Republika e Shqipërisë u njeh të drejtën për azil a mbrojtje të përkohshme të gjithë të huajve që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, qofshin këta refugjatë apo persona të tjerë dhe që kërkojnë azil në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me konventat ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.

2. Ky ligj rregullon kushtet dhe procedurat për dhënien dhe heqjen e azilit në Republikën e Shqipërisë, si dhe të drejtat e detyrat e refugjatëve dhe të personave nën mbrojtje të përkohshme.

Neni 2
Azili

Azil është mbrojtja që Republika e Shqipërisë u jep refugjatëve dhe personave nën mbrojtje të përkohshme. Me azil nënkuptojmë të drejtat dhe detyrat e parashikuara në Konventën e Gjenevës “Për statusin e refugjatëve” të 28 korrikut 1951 dhe Protokollin e Nju-Jorkut 1976, në traktatet ndërkombëtare ku Shqipëria është palë, si dhe në legjislacionin shqiptar.

Neni 3
Azilkërkues

Azilkërkues quhet i huaji që kërkon azil për një nga arsyet e parashikuara në nenet 4 dhe 5 të këtij ligji.

Neni 4
Refugjati

Refugjat është i huaji që për shkak të frikës së bazuar të persekutimit për arsye të racës, besimit, kombësisë, antarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së tij dhe nuk ka mundësi, ose për shkak të një frike të tillë nuk ka dëshirë, të kërkojë mbrojtjen e atij vendi, ose kur ai duke mos pasur një shtetësi dhe ndodhet jashtë vendit të mëparshëm të banimit të zakonshëm të tij si pasojë e këtyre ngjarjeve, nuk ka mundësi, ose nuk ka dëshirë të kthehet atje për arsye të kësaj frike.

Neni 5
Personat nën mbrojtje të përkohshme për arsye humanitare

Personi, që i ofrohet mbrojtje e përkohshme mbi baza humanitare, është i huaji që:

a) megjithëse nuk përmbush kriteret e të qenit refugjat siç janë shprehur në nenin 4 të këtij

ligji, as edhe në dispozitat e parashikuara në kreun V të këtij ligji "Mbi mbrojtjen e përkohshme", nuk do t'i nënshtrohet asnjë urdhri dëbimi apo përzënie të lëshuar nga autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë, nisur nga arsyet përkatëse të shprehura në Konventën Europiane për parandalimin e torturës dhe trajtimit a ndëshkimit çnjerëzor apo degradues, në Konventat e Kombeve të Bashkuara kundër torturës, për të drejtat civile dhe politike, për të drejtat e fëmijës dhe çdo instrument tjetër ndërkombëtar në të cilin Republika e Shqipërisë është ose do të jetë palë;

b) i ofrohet mbrojtje e përkohshme në Republikën e Shqipërisë në përputhje me nenin 31 të kreut V të këtij ligji.

Neni 6

Dhënia e azilit mbi bazën e parimit të bashkimit familjar

1. Të drejtën e azilit, me të njëjtin status, e përfitojnë edhe bashkëshorti, fëmijët e moshës nën 18 vjeç dhe çdo i afërm në ngarkim ligjor të refugjatit, të cilit i është dhënë azil, me kusht që ata të banojnë së bashku.

2. Personi mbi moshën 18 vjeç nuk mund të përfitojë azil në bazë të zbatimit të parimit të bashkimit familjar, sipas paragrafit 1 të këtij neni, veç në rastet kur ai/ajo është në ngarkimin ligjor të prindërve të tij refugjatë të cilëve iu është dhënë azil në Republikën e Shqipërisë. Ai/ajo duhet të paraqesë kërkesë individuale për azil në rast se dëshiron t'i ofrohet azil në Republikën e Shqipërisë

3. Në rastin e zgjidhjes së martesës, ndarjes apo vdekjes së refugjatit që ka përfituar azil, anëtarët e familjes që kanë përfituar azil në përputhje me paragrafin e parë të këtij neni, do të vazhdojnë të gëzojnë të drejtën e azilit. E njëjta gjë zbatohet për fëmijët që gëzojnë azil në përputhje me parimin e bashkimit familjar, kur ata mbushin moshën 18 vjeç.

Neni 7

Moskthimi

Në kuptim të këtij ligji, pavarësisht nga zbatimi i neneve 8 dhe 9, Republika e Shqipërisë njeh dhe respekton detyrimin për të mos kthyer dhe larguar jashtë territorit të vet, personat që kanë përfituar apo kërkuar të drejtën e azilit apo të mbrojtjes së përkohshme në këto raste:

a) Në një shtet ku jeta apo liria e tyre kërcënohen për shkak të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo të bindjeve politike;

b) në një shtet ku ata do t'i nënshtrohen torturës dhe trajtimit a ndëshkimit çnjerëzor e poshtërues, ose çdo trajtim tjetër të parashikuar në traktatet ndërkombëtare ku Shqipëria është palë;

c) në shtetin e tyre të origjinës, në rast se atyre u është dhënë mbrojtje e përkohshme, në përputhje me klauzolat e këtij ligji;

ç) në një shtet të tretë, i cili mund të kthejë a dërgojë personin në një nga shtetet e treguara në pikat "a" dhe "b" të këtij neni.

2. Azilkërkuesi, të cilit kërkesa për azil i është refuzuar nga zyra për refugjatët, nuk dëbohet a kthehet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përpara nënshkrimit a dhënies së mundësive ligjore për ushtrimin e të drejtave procedurale dhe garancive të parashikuara në këtë ligj.

Neni 8

Heqja e azilit

1. Refugjatit, i cili e ka përfituar azilin në përputhje me nenin 4, mund t'i hiqet kjo e drejtë, në njërin nga rastet si vijon:

a) Kur kërkon me vullnetin e vet mbrojtjen e shtetit ku gëzon shtetësinë;

b) kur rimerr me vullnetin e vet shtetësinë të cilën e kishte humbur;

c) kur fiton një shtetësi të re dhe gëzon mbrojtjen e shtetit të shtetësisë së re;

ç) kur rivendoset me vullnetin e vet në shtetin nga ku është larguar ose jashtë të cilit ka qëndruar për motive persekutimi;

d) kur kanë pushuar së ekzistuari rrethanat e parashikuara në nenin 4 dhe nuk ka arsye për të refuzuar mbrojtjen e shtetit të shtetësisë së tij;

dh) kur është person pa shtetësi dhe kanë pushuar së ekzistuar rrethanat për të cilat i është

dhënë e drejta e azilit, si dhe ka mundësitë dhe kushtet për t'u rikthyer në shtetin, nga ku ishte larguar.

2. Përgjegjësia për mbrojtjen ndërkombëtare të personave të njohur si refugjatë në përputhje me Konventën e vitit 1951 dhe Protokollin e vitit 1967, në Republikën e Shqipërisë mund të konsiderohet si e transferuar në një shtet të tretë, palë në instrumentet e lartpërmënuara ndërkombëtare, në rast se ky i fundit ka pranuar që refugjati të qëndrojë si i tillë në territorin e tij në mënyrë të vazhdueshme dhe ka njoftuar Republikën e Shqipërisë mbi këtë veprim.

3. Heqja e azilit bëhet duke zbatuar të njëjtat procedura të parashikuara edhe për dhënien e azilit.

Neni 9

Mohimi i së drejtës të azilit

1. Të huajt që ndodhet në Republikën e Shqipërisë i refuzohet e drejta për azil në rastin kur ka prova të mjaftueshme se ai:

- a) ka kryer krim kundër paqes, krim lufte apo kundër njerëzimit, sipas përcaktimeve të parashikuara në konventat ndërkombëtare;
- b) ka kryer një krim të rëndë ordiner jashtë Republikës së Shqipërisë;
- c) është fajtor për veprime që bien ndesh me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.

Neni 10

Kërkesa dhe aplikimi për azil

1. Kërkesë për azil quhet çdo deklaratë e bërë nga një i huaj pranë organeve kompetente në kufi apo brenda vendit, me anë të së cilës kërkon mbrojtje sipas konventave ndërkombëtare dhe legjislacionit shqiptar.

2. Aplikim për azil quhet kërkesa zyrtare drejtuar zyrës për refugjatët, në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 23 të këtij ligji.

KREU II

TË DREJTAT DHE DETYRIMET

Neni 11

Detyrimet e azilkërkuesve dhe refugjatëve

1. Çdo azilkërkues apo refugjat duhet të respektojë Kushtetutën, ligjet dhe aktet e tjera ligjore në Republikën e Shqipërisë.

2. Asnjë azilkërkues apo refugjat në Republikën e Shqipërisë nuk lejohet të angazhohet në veprimtari të tilla që krijojnë probleme për rendin publik, cenojnë sigurinë kombëtare dhe mund të ndikojnë në marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet e tjera.

3. Azilkërkuesi apo refugjati nuk duhet të veprojë kundër parimeve dhe qëllimeve që burojnë nga traktatet dhe konventat e OKB të pranura nga Republika e Shqipërisë.

Neni 12

Të drejtat e refugjatëve

1. I huaji, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë gëzon status ligjor në përputhje me legjislacionin shqiptar, me Seksionin e Aktit Final të Konferencës së Plotfuqishmëve, me Konventën e OKB-së së vitit 1951 "Për statusin e refugjatëve" dhe me traktatet e tjera ndërkombëtare ku Shqipëria është palë, si dhe të gjitha të drejtat që legjislacioni shqiptar iu njeh të huajve.

2. Refugjati që përfiton azil pajiset me lejeqëndrimi dhe me leje pune të posaçme. Ai gëzon të drejtën e trajtimit social në të njëjtën masë si dhe shtetasit shqiptarë, si dhe përkrahje sociale, të cilat i merr nga zyra për refugjatët.

3. Refugjatët, që përfitojnë të drejtën e azilit në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me normat e përcaktuara në nenin 28 të Konventës së OKB-së "Për statusin e refugjatëve", pajisen nga Ministria e Rendit Publik me dokument udhëtimi, i cili përmban një klauzolë rikthimi. Ky dokument,

për atë kohë sa është i vlefshëm, mund të përdoret për të udhëtuar në të gjitha shtetet, me përjashtim të shtetit të origjinës dhe për t'u rikthyer në Shqipëri.

Neni 13

Të drejtat e azilkërkuesve që u është dhënë individualisht mbrojtje e përkohshme mbi baza humanitare

Çdo azilkërkues, i cili përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 5/a të këtij ligji dhe që i është dhënë mbrojtje e përkohshme mbi baza humanitare individualisht nga autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë, përfiton të drejtat e parashikuara në këtë ligj, të cilat u jepen refugjatëve në përputhje me Konventën e OKB-së të vitit 1951 "Për statusin e refugjatit", përveç dokumentit të udhëtimit.

Neni 14

Të drejtat e azilkërkuesve që u ofrohet mbrojtje e përkohshme si pasojë e situatave të flukseve masive

Çdo person, të cilit i është dhënë mbrojtje e përkohshme, gëzon të drejtat që u jepen refugjatëve, përveçse kur ato kufizohen nga Komisioni Kombëtar për Refugjatët, siç është parashikuar në nenin 32 të këtij ligji.

Neni 15

Të drejtat e azilkërkuesve

1. Azilkërkuesi do të trajtohet në përputhje me dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar që rregullon statusin e të huajve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj.

2. Azilkërkuesit do t'i garantohet:

- a) e drejta e moskthimit sipas nenit 7 të paragrafit 2 të këtij ligji;
- b) e drejta e asistencës sociale në të njëjtën masë si dhe shtetasit shqiptarë, të cilën e merr nga zyra për refugjatët.

Neni 16

Ndalimi i azilkërkuesve

1. Azilkërkuesit që hyjnë ilegalisht në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk do të ndiqen penalisht për kalim të paligjshëm të kufirit, me kusht që ata të paraqiten përpara autoriteteve përkatëse jo më vonë se 10 ditë nga dita e kalimit të paligjshëm të kufirit.

2. Azilkërkuesit, të cilët paraqiten brenda afatit, mund të ndalohen vetëm për arsye të mëposhtme:

- a) Për verifikimin e identitetit të tyre;
- b) kur kanë zhdukur dokumentet e identitetit apo të udhëtimit dhe janë pajisur me dokumente të falsifikuara, për të mashtruar autoritetet përkatëse;
- c) për të është lëshuar një mandat arresti ndërkombëtar;
- ç) për mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe të rendit publik.

3. Masat shtrënguese ndaj një azilkërkuesi merren në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast azilkërkuesit i garantohet kontaktimi me UNHCR-në dhe ushtrimi i të drejtave procedurale penale.

4. Në rast ndalimi e arrestimi, nëse është e mundur, azilkërkuesi mbahet në izolim, i veçuar nga personat e tjerë, përveç kur këto masa shtrënguese merren në bazë të pikës 2, shkronja "b" e këtij neni.

5. Në përputhje me normat ndërkombëtare mbi të drejtat e fëmijëve, të cilat Republika e Shqipërisë i ka ratifikuar, kur është fjala për azilkërkuesit e mitur të pashoqëruar nën moshën 16 vjeç, këta nuk burgosen, përveçse në raste ekstreme. Në çdo rast tjetër ndaj tyre merren masat e duhura dhe të përshtatshme për fëmijët.

KREU III AUTORITETET E AZILIT

Neni 17 **Zyra për refugjatët**

1. Zyra për refugjatët përbëhet nga kryetari i zyrës, zëvendësi i tij dhe 3 anëtarë të cilët janë përgjegjës për regjistrimin e aplikimeve, drejtimin e intervistave dhe grumbullimin e të dhënave të tjera të nevojshme për plotësimin e dokumentacionit për çdo aplikim për azil.

2. Zyra për refugjatët është i vetmi autoritet kompetent për marrjen e aplikimeve për azil, si dhe për dhënien dhe heqjen e azilit në shkallë të parë.

3. Zyra për refugjatët vepron si bashkërenduese për Komisionin Kombëtar për Refugjatët dhe është përgjegjëse për organizimin e mbledhjeve, si dhe për zbatimin e vendimeve të tij.

4. Zyra për refugjatët është përgjegjëse për zbatimin e masave që duhet të merren për mbrojtjen dhe ndihmën që u ofrohet refugjatëve. Autoritetet përkatëse bashkëpunojnë me zyrën për refugjatët në zbatimin e rregullave dhe procedurave të nevojshme për dhënien e të drejtave që u takojnë azilkërkuesve.

5. Zyra për refugjatët administron fondet publike të akorduara në buxhetin e saj, si dhe ndihmat e tjera financiare ose materiale për refugjatët të ofruara nga organizatat vendore apo ndërkombëtare.

6. Zyra për refugjatët është organizmi drejtues në rastet e flukseve masive dhe nën drejtimin e Komisionit Kombëtar për Refugjatët organizon punën për trajtimin e personave që u ofrohet mbrojtje e përkohshme. Ajo është veçanërisht përgjegjëse për regjistrimin, sistemimin dhe shpërndarjen e ushqimeve personave që u është dhënë mbrojtje e përkohshme

Neni 18 **Komisioneri Kombëtar për Refugjatët**

1. Komisioneri Kombëtar për Refugjatët është kryetari i zyrës së refugjatëve.

2. Komisioneri Kombëtar për Refugjatët organizon dhe drejton mbledhjet e Komisionit Kombëtar për Refugjatët, si dhe zbatimin në kohë të vendimeve të këtij Komisioni.

3. Komisioneri Kombëtar për Refugjatët nuk merr pjesë në procesin vendimmarrës për apelimet kundër vendimeve të zyrës për refugjatët.

4. Komisioneri Kombëtar për Refugjatët siguron për çdo azilkërkues të pashoqëruar, nën moshën 18-vjeç apo me të meta mendore një kujdestar, të caktuar në përputhje me legjislacionin shqiptar për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të azilkërkuesit.

5. Komisioneri Kombëtar për Refugjatët inicion me zyrën për refugjatët procedurën për heqjen e azilit, në rast se ka arsye të bazuara, për të menduar së refugjati në fjalë përfshihet në klauzolat për heqjen e azilit, të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji.

6. Komisioneri Kombëtar për Refugjatët mbikëqyr regjistrimin e personave që u është dhënë mbrojtje e përkohshme, si dhe bashkërendon ndihmat e ofruara nga autoritetet vendore dhe organizatat ndërkombëtare.

7. Komisioneri Kombëtar për Refugjatët drejtohet nga udhëzimet e lëshuara nga ministri përkatës.

Neni 19 **Komisioni Kombëtar për Refugjatët**

1. Komisioneri Kombëtar për Refugjatët përbëhet nga 8 anëtarë:

- Komisioneri Kombëtar për Refugjatët
- përfaqësues i Ministrisë së Pushtetit Vendor
- përfaqësues i Ministrisë së Rendit Publik
- përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Jashtme
- përfaqësues i Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale
- përfaqësues i Shërbimit Informativ Kombëtar

- përfaqësues i Komitetit Shqiptar të Helsinkit
- përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Avokatëve

2. Komisioni Kombëtar për Refugjatët është autoriteti i vetëm kompetent vendimmarrës mbi apelimet e bëra kundër vendimeve të zyrës për refugjatët.

3. Anëtarët e Komisionit Kombëtar për Refugjatët caktohen nga institucionet e tyre përkatëse për një periudhë njëvjeçare, me të drejtën e rinovimit të mandatit të tyre, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4. Komisioni Kombëtar për Refugjatët funksionon në bazë të një rregulloreje të brendshme të miratuar nga shumica e anëtarëve të vet.

5. Në situata fluksesh masive, Komisioni Kombëtar për Refugjatët është organ i vetëm kompetent që përcakton nëse një grup i caktuar të huajsh përfiton mbrojtje të përkohshme, si dhe për të revokuar regjimin e mbrojtjes së përkohshme.

Neni 20

Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR)

1. Azilkërkuesit, refugjatët dhe personat nën mbrojtje të përkohshme kanë të drejtë të kontaktojnë me zyrën e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR). Përfaqësuesit e UNHCR-së kanë të drejtë të takohen me çdo azilkërkues, refugjat apo person nën mbrojtje të përkohshme, që ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Zyra për refugjatët dërgon pranë UNHCR-së informacionin e nevojshëm për azilkërkuesit e regjistruar dhe në mënyrë të veçantë i mundëson UNHCR-së, në bazë të kërkesës, shqyrtimin e dosjeve individuale të azilkërkuesve dhe refugjatëve. Zyra për refugjatët i dërgon UNHCR-së listën e aplikimeve që shqyrtohen nga zyra e refugjatëve, si dhe të apeliemeve që do të shqyrtohen në mbledhjet e ardhshme të Komisionit Kombëtar për Refugjatët, me synimin për të siguruar bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve vendase me UNHCR-në në përputhje me nenin 35 të Konventës së Gjenevës së vitit 1951 "Për Statusin e Refugjatëve".

3. UNHCR-ja mund t'u ofrojë zyrës së refugjatëve dhe Komisionit Kombëtar për Refugjatët propozime me karakter të përgjithshëm, si dhe rekomandime për raste të veçanta, apo të flukseve masive.

4. UNHCR-ja mund të marrë pjesë me statusin e vëzhguesit në mbledhjet e zyrës për refugjatët dhe të Komisionit Kombëtar për Refugjatët, që kanë të bëjnë me përcaktimin e statusit të refugjatit.

KREU IV PROCEDURA E AZILIT

Neni 21

Kërkesa për azil

1. Të huajt që dëshirojnë të kërkojnë azil në Republikën e Shqipërisë duhet:

a) T'u drejtohen organeve kompetente në kufi apo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të depozitojnë kërkesën për azil;

b) T'i drejtohen drejtpërdrejt zyrës për refugjatët dhe të depozitojnë aplikimin për azil.

2. Në rastet kur i huaji kërkon azil në përputhje me shkronjën "a", të pikës së parë të këtij neni, organet kompetente bëjnë njoftimin dhe dërgimin e menjëhershëm të tij në zyrën për refugjatët në Tiranë, në mënyrë që të regjistrohet dhe të depozitohet aplikimin për azil.

Neni 22

Identiteti i azilkërkuesve

1. Autoritetet që adresojnë azilkërkuesin në zyrën për refugjatët, ashtu si dhe vetë zyra e refugjatëve, janë përgjegjëse për marrjen e masave të nevojshme për të përcaktuar identitetin e azilkërkuesit.

2. Drejtoria e Policisë Kriminale ofron ndihmën e saj për përcaktimin e identitetit të

azilkërkuesit.

3. Drejtoria e Policisë Kriminale, për të siguruar mbrojtjen e azilkërkuesit, ruan dhe mban në dosje të veçanta të dhënat e grumbulluara në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 23

Aplikimi për azil

1. Aplikimi për azil i paraqitet me shkrim, në gjuhën shqipe apo në njërën prej gjuhëve zyrtare të Kombeve të Bashkuara, zyrës për refugjatët. Aplikimi, përveç identitetit duhet të përmbajë shkaqet dhe arsyet për të cilat azilkërkuesi kërkon mbrojtje në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Në zyrën për refugjatët azilkërkuesi është i detyruar të paraqesë të gjitha të dhënat biografike dhe të mbushë të gjithë formularët që përgatiten nga zyra për refugjatët.

3. Në kohën e mbushjes së aplikimit për azil, azilkërkuesit do t'i ofrohet një broshurë informative mbi procedurat e përcaktimit të statusit të refugjatit. Nëse azilkërkuesi dëshiron, zyra për refugjatët e ndihmon atë të kontaktojë falas me një avokat, ekspert në çështje të refugjatëve apo me UNHCR-në.

4. Për periudhën deri në dhënien e vendimit përfundimtar, lidhur me aplikimin për azil, azilkërkuesi lejohet të qëndrojë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 24

Detyrimet për bashkëpunim

1. Azilkërkuesi është i detyruar të bashkëpunojë për saktësimin e fakteve të parashtruara prej tij. Ai është i detyruar:

a) të japë informacionin e nevojshëm, gojarisht apo me shkrim, sipas kërkesës së autoriteteve përkatëse;

b) të respektojë urdhrat zyrtare, të cilat kërkojnë raportimin apo paraqitjen e tij para autoriteteve apo institucioneve të ndryshme;

c) t'u paraqesë dhe t'u dorëzojë autoriteve përkatëse të gjitha dokumentet që disponon, të nevojshme për zbatimin e rregullave dhe të procedurave të parashikuara në këtë ligj;

ç) të informojë pa vonesë zyrën për refugjatët për adresën e tij më të fundit".

2. Azilkërkuesi informohet mbi faktin se informacionet që ai /ajo jep do të mbahen konfidenciale dhe shërbejnë si bazë për marrjen e vendimit, e për rrjedhim ato duhet të jenë të vërteta dhe të sakta.

Neni 25

Përkthyesit

1. Në rast se azilkërkuesi nuk ka njohuri të mjaftueshme të gjuhës shqipe, atij i jepet një përkthyes i kualifikuar në mënyrë që të komunikojë lirishëm në të gjitha fazat e procedimit të parashikuara në këtë ligj.

2. Azilkërkuesi ka të drejtë të zgjedhë, me shpenzimet e veta, një përkthyes tjetër.

Neni 26

Dëgjimi

1. Azilkërkuesi intervistohet për aplikimin e tij për azil në zyrën për refugjatët. Në rast se dëgjimi nuk kryhet brenda së njëjtës ditë, i huaji informohet menjëherë për datën e dëgjimit, e cila nuk mund të jetë më vonë se 21 ditë nga dita kur i huaji ka depozituar aplikimin në zyrën për refugjatët.

2. Azilkërkuesi mund të shoqërohet, këshillohet apo përfaqësohet nga një avokat. Përfaqësimi nga një avokat nuk e përjashton azilkërkuesin nga detyrimet për t'u përgjigjur pyetjeve që i adresohen atij personalisht.

3. Azilkërkuesit e seksit femër, nëse është e mundur, intervistohen nga punonjëse femra të stafit të zyrës për refugjatët nëpërmjet një përkthyesje femër.

4. Azilkërkuesi shpjegon faktet ku mbështeten arsyet e motivet për persekutimin e tij apo për

shkeljen e të drejtave të njeriut dhe ofron të dhënat e nevojshme, ku përfshihet informacioni për vendin e rezidencës, për itinerarin, për ndalesat në vendet e tjera dhe kërkesat e mundshme për azil në vende të tjera, ashtu si dhe të dhëna të tjera të nevojshme për sqarimin e rrethanave të çështjes.

5. Dëgjimi nuk bëhet publik dhe azilkërkuesit i garantohet konfidencialiteti i dëgjimit. Dëgjimi mund të ndiqet vetëm nga përfaqësuesi i pushtetit qendror apo vendor dhe nga përfaqësuesi i UNHCR-së.

Neni 27

Procedurat në zyrën për refugjatët

1. Zyra për refugjatët regjistron të gjitha të dhënat e rëndësishme ofruar nga azilkërkuesi. Kur aplikimi për azil të jetë plotësuar me të gjitha të dhënat dhe formularët e nevojshëm, zyra për refugjatët i jep azilkërkuesit një dokument, ku vertetohet identiteti i tij dhe pranimi i aplikimit për azil, duke e garantuar për moskthimin e tyre, në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 23 të këtij ligji.

2. Zyra për refugjatët drejton dëgjimin, verifikon faktet e dhëna dhe plotëson dokumentacionin e nevojshëm para marrjes së vendimit. Nëse shihet e arsyeshme dhe kur i kërkohet nga zyra për refugjatët, në dosje vendoset edhe rekomandimi i dhënë nga UNHCR-ja për aplikimin për azil.

3. Zyra për refugjatët e mbështet vendimin e vet në përcaktimet përkatëse të refugjatit, parashikuar në nenet 4, 6, 8 dhe 9 të këtij ligji. Zyra për refugjatët, në marrjen e vendimit mbështetet në parimin e besueshmërisë dhe në prezumimin që azilkërkuesi ka të drejtë. Ajo, gjithashtu, merr parasysh rekomandimet e paraqitura nga UNHCR-ja.

4. Zyra për refugjatët merr vendim brenda 30 ditësh nga dita e dëgjimit të azilkërkuesit dhe i jep, pa vonesë, si azilkërkuesit dhe UNHCR-së një kopje të vendimit, por në çdo rast jo më vonë se 5 ditë nga dita e marrjes së vendimit. Vendimi i zyrës për refugjatët jepet me shkrim dhe duhet të jetë i arsyetuar.

5. Në rast se aplikimi për azil pranohet, zyra për refugjatët informon azilkërkuesin për kushtet e azilit dhe se azili mund të revokohet vetëm në përputhje me nenin 8 të këtij ligji.

6. Në rast se aplikimi për azil mohohet, zyra për refugjatët informon azilkërkuesin me vendimin e saj të shkruar, individual e të arsyetuar, ku do të shprehet e drejta e tij për apelim dhe për periudhën brenda së cilës ai mund të përfitojë nga kjo e drejtë. Nëse zyra për refugjatët nuk jep vendimin e vet brenda afatit kohor prej 51 ditësh nga data e dëgjimit të azilkërkuesit, heshtja e zyrës për refugjatët do të kuptohet si mospranim i nënkuptuar i aplikimit.

Neni 28

Pretendimet abuzive dhe dukshëm të pabazuara

1. Zyra për refugjatët mund ta konsiderojë një aplikim si “abuziv” apo “dukshëm të pabazuar” në ato raste kur:

a) është përcaktuar në mënyrë krejt të pakundërshtueshme se pretendimi i bërë nga azilkërkuesi është i gënjeshtërt për të mashtruar autoritetet;

b) pretendimi i bërë nga azilkërkuesi nuk lidhet në asnjë mënyrë me kriteret për dhënien e azilit, siç është përcaktuar në kreun I të këtij ligji;

c) azili mund t'i mohohet çdo të huaji që vjen nga një vend i tretë, i cili është palë në Konventën e vitit 1951, Protokollin e 1967 ku ai/ajo nuk mund të paraqesë frikë të bazuar persekutimi për të paktën një prej arsyeve të përmbajtura në nenin 1A të Konventës së lartpërmendur, as dhe ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut apo rrezik dëbimi në kuptimin e neneve 4 dhe 6 të këtij ligji dhe nëse ai mund të kthehet ligjërisht në këtë vend ku aplikimi i tij për status refugjati do të shqyrtohet në përputhje me standardet ndërkombëtare.

2. Në rastet kur zyra për refugjatët vendos se një aplikim për azil është “abuziv” apo “dukshëm i pabazuar”, do të aplikohet procedura e përshpejtuar e vlerësimit të apelimit,

a) nëse në fazën e parë të procedurës së përshpejtuar, zyra për refugjatët nuk jep vendimin e saj brenda 10 ditësh, aplikimi do të pranohet automatikisht në procedurën normale të përcaktimit të statusit të refugjatit;

b) azilkërkuesit i jepet një afat 7-ditor për të apeluar nga dita kur ai merr vendimin e zyrës për refugjatët;

c) Komisioni Kombëtar për Refugjatët i trajton këto apeline me përparësi për të arritur në një vendim përfundimtar brenda një afati sa më të shkurtër kohor;

ç) Komisioni Kombëtar për Refugjatët në bazë të informacionit të dosjes mund të vendosë nëse e konsideron të nevojshëm dëgjimin e azilkërkuesit.

Neni 29

Apelimi

1. Apelimi kundër vendimit të zyrës për refugjatët i drejtohet Komisionerit Kombëtar për Refugjatët brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

2. Kërkesa për apelim duhet të përmbajë:

a) shkaqet për të cilat vendimi është i pambështetur në ligj;

b) të dhëna dhe dokumente të tjera shtesë, të cilat nuk janë paraqitur në zyrën për refugjatët.

3. Zyra për refugjatët i paraqet Komisionit Kombëtar për Refugjatët dosjen e plotë të azilkërkuesit, që apelon kundër vendimit të saj.

4. Regjistrimi i kërkesës për apel pezullon vendimin e zyrës për refugjatët. Azilkërkuesi lejohet të qëndrojë në territorin e Shqipërisë për periudhën që apelimi i tij është në shqyrtim.

5. Përpara dhënies së vendimit, Komisioni Kombëtar për Refugjatët dëgjon azilkërkuesin në përputhje me nenin 26 të këtij ligji, përveç kur vendos të pranojë apelimin dhe të japë të drejtën e azilit, në bazë të informacionit që gjëndet në dosje.

6. Komisioni Kombëtar për Refugjatët zbaton të njëjtat parime procedurale që zbatohen nga zyra për refugjatët.

7. Komisioni Kombëtar për Refugjatët merr vendim, jo më vonë se 45 ditë nga dita e depozitimit të apelim. Vendimi i motivuar i Komisionit Kombëtar për Refugjatët i dërgohet azilkërkuesit nëpërmjet zyrës për refugjatët.

8. Vendimi i Komisionit Kombëtar për Refugjatët është përfundimtar.

Neni 30

Refuzimi dhe dëbimi

1. I huaji, kërkesa për azil e të cilit është refuzuar në mënyrë përfundimtare, mund të dëbohet në bazë të legjislacionit shqiptar që rregullon statusin e të huajve.

2. Zyra për refugjatët njofton menjëherë autoritetet kompetente për vendimin përfundimtar të refuzimit të kërkesës për azil.

KREU V

MBROJTJA E PËRKOHSHME

Neni 31

Të përgjithshme

1. Në situata të një fluksi masiv të personave civilë që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në territorin shqiptar, procedurat e parashikuara nga neni 21 deri te neni 30 i këtij ligji për shqyrtimin individual të kërkesave për azil, mund të pezullohen, duke u dhënë të gjithë personave të një grupi mbrojtje të përkohshme.

2. Vendimi për përcaktimin e një grupi personash civilë si pjesëtarë të një fluksi masiv, për dhënien e mbrojtjes së përkohshme apo mbarimin e regjimit të mbrojtjes së përkohshme, merret nga Komisioni Kombëtar për Refugjatët në përputhje me pikën 5, të nenit 19 të këtij ligji. Në marrjen e vendimit, Komisioni Kombëtar për Refugjatët shqyrton rrethanat që kanë çuar në zhvendosjen e tyre dhe verifikon nëse personat që i përkasin këtij grupi, përfitojnë të drejtën e mbrojtjes së përkohshme.

Neni 32

Të drejtat e të huajve, që gëzojnë mbrojtje të përkohshme

1. Të huajt që gëzojnë mbrojtje të përkohshme, pranohen përkohësisht në Republikën e

Shqipërisë.

2. Të drejtat e të huajve që përfitojnë mbrojtje të përkohshme, veçanërisht e drejta për punë dhe liria e lëvizjes, mund të kufizohen për arsye objektive nga Komisioni Kombëtar për Refugjatët gjatë tri viteve të para të qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Në çdo rast, këta të huaj nuk ndiqen penalisht dhe as nuk i nështrohen ndonjë trajtimi të pafavorshëm vetëm sepse kanë shkelur në mënyrë të paligjshme kufirin dhe përgjithësisht trajtohen në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, si dhe me dispozitat përkatëse të këtij ligji.

Neni 33

Mundësia për të shfrytëzuar procedurën e azilit

Të huajt, që bëjnë pjesë në grupin e personave që gëzojnë mbrojtje të përkohshme, kanë të drejtën që, me mbarimin e kësaj mbrojtjeje, të paraqesin aplikim për azilin, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në këtë ligj.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 34

Anullimi

Neni 22 pika 1 dhe nenet 24, 25, 26, 27 dhe 28 të ligjit nr.7939, datë 25.5.1995 "Për emigracionin", që i referohet azilit në Republikën e Shqipërisë, shfuqizohen.

Neni 35

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2283, datë 28.12.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**